REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE PUBLIKE, ZHVILLIMIT URBAN DHE RURAL
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT, ZHVILLIMIT TË TERRITORIT DHE MJEDISIT

Nr. 2703 Prot. Lushnjë 17 / 03 / 2026

RELACION

KËSHILLIT BASHKIAK
(këtu)

"PËR MIRATIMIN E PRISHJES SË OBJEKTIT (GODINA QENDRËS SHËNDETËSORE) NDODHUR NË PASURINË ME NR. 301/1/1 ZK. 1615, DHE NDËRTIMI I QENDRËS SHËNDETËSORE FSHATI FIERSHEGAN, NJËSIA ADMINISTRATIVE FIERSHEGAN, BASHKIA LUSHNJË"

Të nderuar këshilltare/ këshilltarë

Në Inventarin e Pronave të Paluajtshme Shtetërore të ish Komunës Fiershegan, sot Njësia Administrative Fiershegan, Bashkia Lushnjë miratuar me VKM-në nr. 30 datë 21.05.2004, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, në Komunën Fiershegan" sot njësia Administrative Fiershegan, Bashkia Lushnjë bën pjesë pasuria me nr. 301/1/1, me numër rendor 40, Z.K. 1615, me emërtim "Ndërtesë", fshati Fiershegan, e llojit ndërtesë me sipërfaqe 260 m² truall dhe 110 m² ndërtesë.
Funksioni për të cilën përdoret është Shërbim Shëndetësor Parësor, Institucioni/Enti me përgjegjësi administrative është Ministria e Shëndetësisë dhe Institucioni/Enti përdorues është Drejtoria e Shëndetit Publik Lushnjë.

Me shkresën nr. 141 prot. datë 09/03/2026 protokolluar në institucionin Bashkia Lushnjë me nr. 2479 prot. datë 09/03/2026 Njësia Administrative Fiershegan na informon se ndërtesa e Qendrës Shëndetësore ndodhet në pasurinë 301/1/1 Z.K. 1615 sipërfaqja e pasurisë 260 m² nga këto ndërtesë me sipërfaqe 110 m²

Nga ankesat e ardhura nga banorët në dëgjesat publike që janë realizuar për problematikat që kjo Qendër Shëndetësore ka si dhe ato të ngritura nga stafi që shërben në këtë Qendër Shëndetësore, Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit dhe Mjedisit kreu verifikimet në terren ku u konstatua:

1. Themelet janë të amortizuar si rezultat i futjes së ujit për një kohë të gjatë.
2. Mungojnë kolonat antisizmike, duke ulur sigurinë.
3. Dyshemeja ka pësuar çedime pjesore duke u ulur me disa centimetra.
4. Muret perimetralë kanë pësuar çedime gjë kjo që ka sjellë dhe plasaritje të konsiderueshme.
5. Soleta e objektit është tejet e amortizuar me plasaritje dhe prezencë lagështie.

Adresa:Lagjja Kongresi Lushnjes Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com

6. Lartësia nga toka e godinës është e vogël, gjë e cila shkakton shumë lagështi dhe myk, dhe në raste shirash dhe përmbytje të objektit.

Si rrjedhojë nga Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit dhe Mjedisit është planifikuar projekti për Ndërtimin e Qendrës Shëndetësore Fiershegan në pasurinë 301/1/1, Z.K. 1615, fshati Fiershegan, Njësia Administrative Fiershegan, Bashkia Lushnjë. Objekti i planifikuar është 1 kat, sheshi i ndërtimit për objektin është 260 m² dhe sipërfaqja e objektit është 90 m².

Projekti i ndërtimit të Qendrës Shëndetësore fshati Fiershegan i realizuar nga Bashkia Lushnjë, ka si qëllim përmirësimin e kushteve dhe rritjen e cilësisë së shërbimit shëndetësor në këtë zonë. Në projektin e ri janë parashikuar hapësira të përshtatshme për të mbuluar nevojat e qytetarëve dhe stafit që shërben në të.

Vlera e plotë e projektit është 7,993,702.12 lekë të cilat do të mbulohen nga Bashkia Lushnjë për vitin 2026.

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1, shkronja b të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, nenit 4, nenit 5 pika 1.3 gërma a, nenit 12 të ligjit nr. 107 datë 31/07/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar propozojmë:

1. Prishjen e objektit ekzistues të ndodhur në pasurinë nr. 301/1/1, Z.K. 1615 me emërtim në inventar "Ndërtesë", fshati Fiershegan, e llojit ndërtesë me sipërfaqe 260 m² truall dhe 110 m² ndërtesë.

2. Ndërtimin e Qendrës Shëndetësore fshati Fiershegan, në pasurinë 301/1/1, Zk. 1615, objekt 1 kat, sheshi i ndërtimit për objektin është 260 m² dhe sipërfaqja e objektit të ri është 90 m

Ju faleminderit për mirëkuptimin!

Konc. Ark. Alban Manoku

Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Të Territorit
Ing. Ariola Beqo

Adresa:Lagjja Kongresi Lushnjes Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJË

Nr. 2703/1 **Prot.** **Lushnjë më** 17 / 03 / **2026**

PROJEKT-VENDIM
NR. 29 **DATË** 17/03 **/2026**

" PËR MIRATIMIN E PRISHJES SË OBJEKTIT (GODINA QENDRËS SHËNDETËSORE) NDODHUR NË PASURINË ME NR.301/1/1, ZK.1615, DHE NDËRTIMI I QËNDRËS SHËNDETËSORE FSHATI FIERSHEGAN, NJËSIA ADMINISTRATIVE FIERSHEGAN, BASHKIA LUSHNJË."

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e radhës në datë ____/____/2026, në mbështetje të nenit 9 pika 1.2/a/c, neni 23 pika 13 të ligjit nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore"i ndryshuar.Neni 113, pika 2 të Kushtetutës se Republikës të Shqipërisë. Neni 4, neni 5, pika 1.3, gërma a, neni 12, neni 22 të ligjit nr.107 datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar dhe VKM-së nr.30 datë 21.05.2004 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, në Komunën Fiershegan".Ju:

PROPOZOJMË:

1. Të miratojë prishjen e objektit (Godina Qendrës Shëndetësore) Njësia Administrative Fiershegan, Bashkia Lushnjë ndodhur në pasurinë me nr.301/1/1, zk.1615 me sipërfaqe 110 m2, dhe ndërtimi i Qëndrës Shëndetësore fshati Fiershegan, me sipërfaqe ndërtimi 90 m2.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit Vendor, Policia Bashkiake,Ndërmarrja e Pasurisë Publike, Njësia Adminstive Fiershegan, Drejtoria e Planifkimit dhe Zhvillmit të Territorit, Bashkia Lushnje.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

DREJTORIA JURIDIKE
Bedri Hida

DR. E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TERRITORIT
Ariola Beqo

KRYETARI I BASHKISË
Eriselda Sefa

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA LUSHNJË

Adresa:Lagjja Kongresi Lushnjes Tel:+355 35 222139 Email:bashkia_lushnje@yahoo.com